



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë më, 08.11.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtim në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019” me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga Ministria e Mbrojtjes.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Pjerin Ndreu, Xhemal Qefalia, Luan Duzha, Luan Harusha, Paulin Sterkaj, Sadi Vorpsi, Vullnet Sinaj, Anduel Xhindi, Klodjana Spahiu dhe Spartak Braho.

Mungojnë:

Andon Frrokaj, Luan Rama, Elona Hoxha, Myslym Murrizi, Ervin Salianji, Flamur Noka, Endrit Brahimllari, Xhemal Gjunksi dhe Isuf Çela

Të ftuar :

Olta Xhaçka - Ministre e Mbrojtjes

Gjeneral Bardhyl Kollçaku - SHSHPFARSH

Alba Thoma - Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Mbrojtjes

Nuri Laknori - Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Mbrojtjes

Gentian Opre –Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit në Ministrinë e Financave

Ina Dhaskali - Përgjegjëse Sektori e Drejtorisë së Buxhetit në Ministrinë e Financave

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëmëngjesi!

Mirëmëngjesi, zonja Ministre!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Sigurisë Kombëtare. Sot në rendin e ditës kemi shqyrtimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019”, konkretisht sa i takon buxhetit për Ministrinë e Mbrojtjes.

Për të na prezantuar buxhetin në emër të Ministrisë së Mbrojtjes të ftuar në komision janë, zonja Olta Xhaçka, ministre e Mbrojtjes, Gjeneral Bardhyl Kollçaku, zonja Alba Thoma, Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Mbrojtjes, zoti Nuri Laknori, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Mbrojtjes, zonja Ina Dhaskali, përgjegjëse Sektori e Drejtorisë së Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe zoti Renald Petriti, specialist i Ministrisë së Financave, si dhe zoti Gentian Opre, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit në Ministrinë e Financave.

Kolegët e komisionit janë njohur me projektbuxhetin dhe përpara kanë një material të përgatitur nga stafi i komisionit për këtë buxhet, ndërkohë që relator i komisionit për buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes është zoti Xhemal Qefalia.

Për të na prezantuar buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes, fjalën e ka zonja ministre.

Olta Xhaçka – Ju falënderoj!

Të nderuar kolegë,

Në këtë seancë dëgjimore do të relatoj projektbuxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2019. Drejtimi sa më efikas i një strukture, si Ministria e Mbrojtjes, e cila tashmë ka marrë më shumë përgjegjësi në sigurinë e brendshme krahas detyrimeve tradicionale të mbrojtjes kërkon edhe një mbështetje më të arsyeshme, më të mirë buxhetore. Me anë të këtij projektbuxheti synojmë vijimësinë e përmbushjes së objektivave si në planin kombëtar, edhe të detyrimeve që kemi ndaj NATO-s.

Ky projektbuxhetet bazohet në dokumentet kryesore të planifikimit strategjik të mbrojtjes, në strategjinë e sigurisë kombëtare, në strategjinë ushtarake dhe mbështet planin afatgjatë të zhvillimit të Forcave të Armatosura. Në këtë kuadër projektbuxheti i Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2019 është hartuar, duke u bazuar në kërkesat e strukturave të Forcave të Armatosura për ruajtjen dhe plotësimin e kapaciteteve për të gjithë zërat buxhetorë, duke filluar nga shpenzimet e personelit, shpenzime për mallra dhe shërbime, shpenzime për transfertat

kombëtare dhe ndërkombëtare, ashtu edhe për zërin e shpenzimeve kapitale, që është shumë i rëndësishëm për buxhetin tonë, pasi ka të bëjë me projektet e investimeve. Në rast se do të shohim kategoritë e shpenzimeve për vitin 2019 për Ministrinë e Mbrojtjes, ato paraqiten si më poshtë:

- mbështetja për personelin në masën 32% të totalit të shpenzimeve;
- operacionet brenda dhe jashtë vendit dhe emergjencat civile në masën 6% të shpenzimeve;
- stërvitjet kombëtare dhe ndërkombëtare në masën 4% të shpenzimeve;
- arsimimi dhe kualifikimi në masën 3% të shpenzimeve;
- strukturat dhe angazhimet ndërkombëtare në masën 2% të shpenzimeve;
- modernizimi i Forcave të Armatosura me pajisje në masën 9% të shpenzimeve;
- përmirësimet infrastrukturore në masën 2% të shpenzimeve;
- mbështetje me mallra dhe shërbime në masën 29% të shpenzimeve;
- mbështetja për shëndetësinë në masën 4% të shpenzimeve;
- shpenzimet e tjera operative në masën 9% të totalit të shpenzimeve.

Ne kemi përcaktuar prioritetet kryesore për mbështetjen me burime mbrojtëse të kategorive të mësipërme, të cilat mbështesin këto programe buxhetore që janë:

- forcat e luftimit ose 36% e shpenzimeve që janë për këtë program;
- mbështetja e luftimit ose 26% e shpenzimeve që janë për këtë program;
- strukturat e tjera të Forcave të Armatosura në të cilat përfshihen programe të tjera buxhetore në masën 14% të shpenzimeve dhe mbështetja sociale për ushtarakët në masën 24% të shpenzimeve.

Duke analizuar kategoritë e shpenzimeve për vitin 2019, si dhe raportet në përqindje të kategorive të shpenzimeve korrente dhe atyre kapitale ndaj totalit të buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes, konstatojmë se shpenzimet kapitale ose artikulli 231, që ka të bëjë me projektet e investimeve për vitin 2019, zë 11% të buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes, ndërkohë që totali ose buxheti total i Ministrisë së Mbrojtjes është në masën 1,2% të prodhimit të brendshëm bruto.

Më lejoni të sjell në vëmendjen tuaj që në samitin e NATO-s i mbajtur në Uells në shtator të vitit 2014, kryetarët e shteteve dhe të qeverive të Aleancës pa përjashtim morëm zotimin për ndalimin e tendencës së uljes së buxheteve të mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO-s, si dhe rritjen graduale të buxhetit për të arritur nivelin 2% të PBB-së deri në vitin 2024.

Gjithashtu, samiti orientoi edhe balancën ndërmjet zërave buxhetorë me tendencë rritjen e shpenzimeve kapitale në masën 20% të buxhetit të mbrojtjes, me qëllim që t'i kushtohet më shumë vëmendje modernizimit të Forcave të Armatosura, pasi modernizimi rrit kapacitet dhe mundëson realizimin e misionit. Në përputhje me këtë zotim edhe vendi ynë i është bashkuar Aleancës dhe ka marrë angazhimin politik, por edhe publik për rritjen e buxhetit dhe njëkohësisht rritjen e nivelit të shpenzimeve kapitale dhe ky angazhim u është përcjellë edhe instancave më të larta drejtuese të NATO-s, si dhe aleatit tonë strategjik, të cilët e monitorojnë me shumë kujdes këtë proces të rëndësishëm dhe domethënës për përkushtimin tonë ndaj Aleancës. Vlerësimi i mjedisit të sigurisë nga ana e Aleancës e ka bërë edhe më imperative dhe më të domosdoshme arritjen e këtij objekti.

Bazuar në sa më sipër, duke marrë në konsideratë edhe kushtet specifike dhe të përgjithshme makro-ekonomike, si dhe kapacitetin fiskal të vendit tonë, gjykojmë se duhet të ketë një qasje më të kujdesshme ndaj buxhetit të mbrojtjes në mënyrë që të përmbushim detyrimet tona kushtetuese, si dhe ato që rrjedhin nga pjesëmarrja në Aleancë, në NATO.

Me anë të këtij projektbuxheti Ministria e Mbrojtjes synon të arrijë disa objektiva të rëndësishëm jo vetëm në fushën e mbrojtjes, por edhe në aspekte të tjera, të cilat në mënyrë ndoshta jo të drejtpërdrejtë ndikojnë jo pak në ekonominë e vendit tonë. Ndër objektivat ushtarakë që do të mbështesë ky buxhet, do të doja të theksoja modernizimin e Grup Batalionit të Këmbësisë së Lehtë. Është një ndër angazhimet kryesore që ne kemi ndërmarrë me Aleancën. Ky është një objektiv më madhorë jo vetëm të sigurisë kombëtare, por edhe një detyrim shumë i rëndësishëm i vendit tonë ndaj NATO-s në kuadrin e mbrojtjes kolektive.

Një objektiv tjetër është përmirësimin e kapaciteteve të tjera dhe pajimeve bazë për ushtarakët e Forcave të Armatosura, që ka të bëjë me sistemet e pajisjeve për Forcat e Armatosura, të cilat nevojiten për mbështetjen e veprimtarisë së forcës sonë të armatosur si brenda ashtu edhe jashtë vendit.

Një prioritet tjetër është modernizimin e sistemeve të komunikimit dhe të informacionit dhe vënia në funksion e Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Ajrore. Është një projekt në vazhdimësi që prej vitit 2017, që kap një vlerë totale prej 22 milionë dollarë, me një shtrirje kohore në tre vite buxhetore. Gjithashtu, ky projekt po zhvillohet me ndihmën e partnerit tonë strategjik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe rëndësia e tij është e një prioriteti të veçantë.

Një tjetër prioritet është përmirësimi i funksionimit të Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Detare. Këto sisteme janë mjaft të rëndësishme për aspektet e sigurisë së vendit, për kontributit tonë në arkitekturën e sigurisë së NATO-s, por edhe bashkëpunimit ndërinstitucional për luftën ndaj trafikeve të paligjshme.

Të tjera prioritete janë përmirësimet infrastrukturore. Forcat e Armatosura, do të administrojnë, zhvillojnë dhe mirëmbajnë një infrastrukturë bashkëkohore për jetesë, edukim, stërvitje, mbështetje të operacioneve dhe komandim-kontrollin e strukturave ushtarake në kohë paqeje, krize apo lufte.

Prioritete të tjera janë investimet, ose më saktë ky është prioriteti më madhor, investimi për modernizimin e bazës së Kuçovës. Siç jeni në dijeni, Këshilli i Atlantikut të Veriut ka marrë vendimin për ta përdorur bazën ajrore të Kuçovës si bazë mbështetëse të NATO-s. Për këtë është rënë dakord, për modernizimin e saj, nëpërmjet zbatimit të disa projekteve që do të jenë investim i përbashkët midis qeverisë shqiptare dhe NATO-s. Ky do të jetë një projekt shumë ambicioz që e fut vendin tonë në hartën e pikave të rëndësishme të NATO-s. Besoj se të gjithë biem dakord që ndërtimi i një baze të tillë sjell me vete përfitime të shumfishta.

Së pari, rritet niveli i sigurisë së vendit dhe rritja e perceptimit të sigurisë rrit edhe mundësinë e thithjes së investimeve të huaja. Do të ketë një rivitalizim pa diskutim të ekonomisë lokale, nëpërmjet përmirësimeve të infrastrukturës, punësimeve dhe biznesit të shërbimeve, por jo vetëm. Ky do të jetë një investim i atyre përmasave dhe një mundësi për të cilën ne duhet të jemi shumë seriozë në bashkëpunimin me Aleancën dhe këtë seriozitet duhet ta tregojmë edhe me hartimin e buxhetit këtë vit.

Ky buxhet do të zhvillojë kapacitetet operationale të Forcave të Armatosura në fushat e kapaciteteve të kërkim–shpëtimit, të cilat përfaqësojnë aftësitë e Forcës sonë të Armatosur për të realizuar operationet e kërkim-shpëtimit në tokë, ajër dhe në det, kapacitetet e ndërveprueshmërisë brenda komponentëve të saj, si dhe me institucionet dhe agjencitë e tjera kombëtare, si edhe me forcat aleate; kapacitete të komandim-kontrollit, të cilat përfaqësojnë aftësitë për të ushtruar autoritetin dhe përgjegjësitë e drejtimit për përmbushjen e misionit; si dhe kapacitete për përsosjen e procesit të rekrutimit, i cili është shumë i rëndësishëm, duke rritur bashkëpunimin me institucionet qendrore dhe lokale, si dhe me institucionet arsimore dhe shoqërinë civile si faktor kryesor për të rekrutuar në Forcat e Armatosura kandidatë me kapacitete gjithnjë e më të larta fizike dhe intelektuale.

Ministria e Mbrojtjes ka marrë tashmë në vartësi institucionale edhe Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit. Marrja e këtyre strukturave na i shton më shumë detyrimet edhe në aspektin financiar. Tani, përveç ndërhyrjeve në përballimin e emergjencave civile kemi hyrë në një fazë të re ku po mundohemi të kryejmë edhe punime parandaluese, të cilat, pavarësisht se ulin kostot pas përballjes me emergjencat civile, kanë edhe ato koston e tyre. Gjithashtu, kemi edhe detyrimin e kompensimit të dëmeve të shkaktuara ndaj pronës private të qytetarëve nga emergjencat civile që reflektohen edhe si borxhe të trashëguara nga Ministria e Brendshme me marrjen si fushë përgjegjësie të emergjencave civile.

Me fondet e akorduara për Ministrinë e Mbrojtjes, po ashtu, veç përmbushjes së misionit kushtetues të Forcave të Armatosura, do të kryejmë edhe punime në ndihmë të komunitetit. Gjykojmë, se kjo nuk është detyra jonë parësore, por është një detyrë shumë e rëndësishme për ne, bëhet fjalë për ndërhyrjen në infrastruktura në zonat e thella përmes ndërtimit të urave “Bailey”, pastrimeve të hotspoteve, largimeve të masiveve shkëmborë që bllokojnë akset rrugore apo përbëjnë kërcënim për sigurinë e qytetarëve, vizita mjekësore me mjekët dhe infermierët tanë te komunitetet në zona të thella. Pra, krahas detyrimeve ligjore, një pjesë e fondeve do të kanalizohen edhe për mbështetje ndaj komunitetit dhe rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve tanë.

Prioritet për Forcat Armatosura për vitin 2019, do të jetë edhe rritja e trajtimit financiar dhe motivimi i personelit tonë. Do të synojmë modernizimin e edukimit dhe të trajnimit të tyre sipas standardeve të NATO-s. Kemi një kontribut të qenësishëm në angazhimet, në strukturat dhe operacionet në kuadrin e Aleancës dhe synimi, por edhe kërkesa e NATO-s është rritja e mëtejshme e këtij kontributi dhe përfaqësimi. Vendi ynë është pjesëmarrës në iniciativat e sigurisë rajonale dhe për vitin 2019 do të marrë drejtimin e disa prej tyre, gjë, e cila po ashtu kërkon mbështetje me fonde buxhetore për mirëfunksionimin e këtyre strukturave. Aktualisht sapo kemi përfunduar ndërtimin e qendrës për bashkëpunim dhe siguri RACVIAC që ndodhet në Kroaci, vitin tjetër do të marrim drejtimin e SEDMI-t ose Ministerialit të Mbrojtjes së Europës Juglindore dhe Sekretariatit të SEDMI-t, po ashtu do të marrim edhe kryesinë e “A5” që është SHBA dhe Karta e Adriatikut.

Të nderuar kolegë, me këto argumente që ju parashtrova më sipër, si dhe duke marrë në konsideratë angazhimin politik të qeverisë sonë në NATO për rritjen e buxhetit të mbrojtjes në

masën 1,25% të PBB-së për vitin 2019, do të kërkoja mbështetjen tuaj për realizimin e këtyre objektivave dhe prioriteteve dhe rritjen e buxhetit të mbrojtjes në masën 1,25% të PBB-së.

Ndërkohë, ju siguroj që Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura do të realizojnë me korrektesë maksimale detyrimet dhe do të rrisin në mënyrë të pandërprerë transparencën dhe eficiencën e shpenzimeve buxhetore.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Ministre, për prezantimin nga ana juaj!

Sigurisht që buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes së bashku me buxhetin e Ministrisë së Brendshme, diskutimi i tyre në vetvete paraqet një nga momentet më të rëndësishme të diskutimeve që zhvillohen në Kuvendin e Shqipërisë, kjo edhe për shkak të kompetencave dhe përgjegjësi që ushtrojnë respektivisht secili nga këto institucione qendrore. Sa i takon Komisionit të Sigurisë Kombëtare mund të them se ne konstatojmë me kënaqësi se buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes ka ardhur në rritje, në krahasim me vitin e kaluar. Relatori për këtë projektbuxhet, zoti Qefalia, besoj se do të na thotë diçka më në detaj. Ne jemi në mbështetje të kërkesave tuaja buxhetore dhe në vijimësi do të donim të diskutonim me ju edhe disa probleme të tjera që mund të dalin nga pyetjet e kolegëve.

Xhemal Qefalia- Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zonja Ministre që ma lehtësove mënyrën e relatimit të këtij buxheti për vitin 2019.

Ministria e Mbrojtjes të gjithë buxhetin e akorduar për vitin 2018, nga të gjitha informacionet që kemi ne si Komision Sigurie, ka ditur ta implementojë dhe ta çojë në favor të të gjitha forcave dhe planit të veprimit që ka pasur. Janë për t'u evidentuar shumë nga aktivitetet, që ju keni zhvilluar si ministri edhe me prezencën e Komisionit të Sigurisë, që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me detyrat dhe angazhimet që ka pasur dikasteri juaj për të arritur në kulminacione në stërvitjet e përbashkëta që janë zhvilluar me partnerët, ku Forcat e Armatosura të Shqipërisë kanë treguar performancën e duhur për t'u renditur përkrah vendeve anëtare të NATO-s.

Për herë të parë tashmë Forcat e Armatosura të Shqipërisë dhe Ministria e Mbrojtjes arrijnë që të kapin një shifër rekord në vlerën e 25% të buxhetit të brendshëm bruto. Kjo është një kërkesë që është bërë edhe nga presidenti Tramp në samitin e Uellsit, por është edhe një angazhim i qeverisë shqiptare për të përmbushur të gjitha obligimet që ka në kuadër të rreshtimit në NATO.

Për informim të opinionit publik, tashmë Shqipëria renditet në vende të cilat janë vërtet për t'u pasur zili. Me shifrën 1,25 % tashmë jemi përkrah Gjermanisë, Francës, Italisë dhe Spanjës,

duke lënë pas vende me shumë eksperiencë dhe vite në NATO, Çekinë, Hungarinë, Kanadanë, Belgjikën, të cilat kanë një buxhet me vlerën rreth 1,1 %.

Ajo çka doja t'ju thosha është se edhe ky buxhet, në gjitha detajimet e tij, është fokusuar pikërisht në rritjen e kapaciteteve dhe të infrastrukturës së Ministrisë së Mbrojtjes dhe kryesisht të Forcave të Armatosura duke pasur një plan afatgjatë të zhvillimit.

Gjithashtu, ky buxhet do të kalojë drejtpërdrejt edhe në vijim në pjesëmarrjen e operacioneve të NATO-s, duke rritur nivelin dhe angazhimin e Forcave të Armatosura në operacionet e aleancës me pjesëmarrje në të gjitha misionet dhe iniciativat e reja që ka NATO edhe në të ardhmen.

Gjithashtu, përmbushja e këtij buxheti dhe shpërndarja e tij do të shkojë në zhvillimin dhe mbajtjen në gatishmëri të të gjitha kapaciteteve të Forcave të Armatosura për operacionet e mbrojtjes kombëtare, njëkohësisht edhe për detyrën që mori vjet në përballimin e emergjencave civile dhe dhënien e ndihmës së vendeve të rajonit në raste emergjencash në kuadrin e NATO-s ose OKB-së.

Ky buxhet do të fokusohet edhe në lartësimin e figurës së ushtarakut, në rritjen e tij nëpërmjet zhvillimit të politikave të nevojshme në fushën e personelit. Siç e thashë edhe në fillim, ky buxhet, ndryshe nga të gjitha buxhetet e tjera, ka një rritje të jashtëzakonshme. Në fakt, në qeverisjen socialiste kemi një rritje drastike gati nga 14 miliardë 231 milionë e 500 mijë lekë që ishte në vitin 2014, ka arritur në bumin më të madh, pra në nivel 6% më shumë se viti tjetër dhe tashmë në vitin 2019 parashikohet në vlerat e 21 miliardëve. Pra, kjo tregon edhe një herë vëmendjen e qeverisë dhe të kryeministrit Rama që Forcat e Armatosura të Shqipërisë të meritojnë vendin që duhet përkrah vendeve anëtare të NATO-s.

E përmendi ministrja, por do ta përsëris edhe unë faktin që pjesëmarrja e Forcave të Armatosura në Afganistan, Mosul dhe shumë vende të tjera ka bërë të mundur që Shqipëria të konsiderohet dhe të vlerësohet në mënyrë të përhershme nga Këshilli i Atlantikut të Veriut. Gjithashtu, kjo ka bërë të mundur që për herë të parë, Shqipëri, ajo që përmendi edhe ministrja, të bëhet vend anëtar në infrastrukturë të NATO-s. Kështu që komunitetit i zonës së Kuçovës do të ketë përfitimet e saj, por ajo çka është më e rëndësishme, është prestigji dhe autoriteti që u jepet Forcave të Armatosura dhe që konsiderohet një vend strategjik për NATO-n.

Së fundi, në cilësinë relatorit i ftoj kolegët ta miratojnë këtë projektbuxhet.

A mund të bëj një pyetje, zonja kryetare?

Ermonela Felaj – Po.

Në momentin kur do të marrim përgjigjet e gjitha pyetjeve për konstatimet që ky komision ka bërë pranë QNOD-së dhe Komandës së Forcave Detare, për shkak se informacioni është konfidencial, do t'u lutem kamerave të dalin jashtë dhe ndërkohë ne sqarojmë të gjitha pyetjet.

Xhemal Qefalia - E kam të qartë këtë.

Në fillim të vitit që po mbyllim u bë kalimi i emergjencave civile në juridiksionin e Ministrisë së Mbrojtjes. Duke e parë në tërësi buxhetin, a mendoni se ka ardhur koha për ta riparë ligjin e emergjencave civile pasi disa nga aktorët e tjerë, të cilët përgjigjen drejtpërdrejt për emergjencat, si pushteti lokal, prefekturat e të tjera abuzojnë me idenë se është ushtria, dhe përdoren Forcat e Armatosura. Kjo ndikon drejtpërdrejt në konsumimin e buxhetit. A mendoni ju se ka ardhur koha ta ribëjmë një ligj që gjithsecili të angazhohet për emergjencat civile?

Ermonela Felaj - Hapim kështu seancën e pyetjeve.

Po, fjala për ju, zonja Ministre.

Olta Xhaçka - Faleminderit, zoti Qefalija!

Kjo është një pyetje shumë e mirë, sepse bëhet fjalë për një çështje shumë të rëndësishme, që do të thotë një ndarje më të mirë të barrës sa i takon adresimit të emergjencave civile ose të fatkeqësive natyrore, jo thjesht për të ndarë përgjegjësinë, por për të adresuar më mirë ato problematika që cenojnë sigurinë, por edhe pronën dhe pasurinë e qytetarëve shqiptarë.

Ligji i ri për mbrojtjen civile është në përfundim. Shumë shpejt do t'i nënshtrohet diskutimit edhe në komisionet parlamentare. Bëhet fjalë për një ligj, i cili transpozon direktivën e europiane në masën më të mirë të mundshme, por mbi të gjitha bëhet fjalë për një ligj, i cili ndan më mirë përgjegjësitë e aktorëve, të cilët janë përgjegjës për planifikimin, parandalimin e emergjencave civile, fatkeqësive natyrore dhe pasojave të tyre. Sot një pjesë e madhe e përgjegjësisë i takon pushtetit vendor, i cili duke mos dedikuar buxhet aq sa duhet, duke mos deklaruar kapacitete ashtu siç duhet për emergjencat civile, i ka bërë bisht kësaj përgjegjësie. Ligji i ri parashikon që edhe pushteti vendor, edhe ai qendror, përmes të gjitha institucioneve që kanë përgjegjësi për planifikimin, parandalimin dhe përballimin e fatkeqësive natyrore ose emergjencave civile, t'i kenë këto përgjegjësi të ndara qartazi.

Gjithashtu, bashkëlidhur këtyre përgjegjësive janë edhe penalitetet për të gjithë ata që nuk veprojnë siç duhet. Kjo do të thotë një ndarje më e mirë e detyrave për pushtetin vendor dhe atë qendror, sepse, në fakt, ligji nuk ka qenë shumë i qartë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Na vjen mirë që ligji është në draft, që është i gatshëm për t'u diskutuar në parlament dhe qeveri.

Ne javën e ardhshme kemi planifikuar të thërrasim për shkak të diskutimit të buxhetit Drejtorinë e Emergjencave Civile për t'u njohur edhe me planin që kanë emergjencat civile për të përballuar stinën e ftohtë, kështu që besoj se detajet do të na ndihmojnë për të kuptuar në vijim edhe si do të përdoret buxheti i vitit 2019 dhe si ligjin mund ta kemi instrumentin më të mirë që emergjencat të jenë sa më efektive.

Paulin Sterkaj- Më vjen mirë që ju jeni e kënaqur me buxhetin që i ofron qeveria Ministrisë së Mbrojtjes.

Unë e di që Ministria e Mbrojtjes dhe ushtria jonë paraqitet në çdo takim ndërkombëtar, në çdo mision ndërkombëtar pozitivisht, por është një shqetësim personal imi që pagat në Ministrinë e Mbrojtjes janë pak a shumë diskriminuese në krahasim me institucionet e tjera, kështu që unë mendoj se rritja e buxhetit duhet të parashikojë edhe rritje më të madhe se sa e keni parashikuar ju në buxhet. Do të ishte shumë më mirë që, kur ka misione në Afganistan ose vende të tjera, ka konkurrencë për të marrë pjesë. Kjo nuk është asgjë tjetër veç pasionit, është edhe fakti që ushtarakët shqiptarë të përfitojnë diçka nga të ardhurat që marrin në misione. A ka ardhur koha që ushtarakët shqiptarë të jenë më me dinjitet sa i takon pagës dhe të trajtojnë veten dhe familjen e vet disi më mirë, sepse është e vetmja pjesë që sot ballafaqohet me ndërkombëtarët, ushtarakët, dhe marrin një rrogë që të mos përballojnë elementet minimal të jetesës, kjo nuk më duket e drejtë.

Olta Xhaçka - Është një shqetësim, që në fakt, e ka pasur Ministria e Mbrojtjes edhe para se unë të merrja detyrën. Hera e fundit që janë rishikuar pagat e ushtarakëve ka qenë shumë vite më parë, nuk po citoj vitin, sepse duket si kohë e gjatë. Kanë përfituar herë pas here nga një rritje e përgjithshme, por jo domethënëse për një trajtim të ndjeshëm të përmirësuar ndaj tyre, por me këtë buxhet edhe ministri i Financave, edhe Kryeministri kanë shprehur vullnetin për rritjen e pagave dhe një trajtim më të mirë për ushtarakët. Bëhet fjalë për një rritje të përshkallëzuar nga gradat më të ulëta deri te grada major, jo për nënkolonel, jo për kolonel, jo për gjeneral, të cilët gëzojnë një trajtim relativisht të mirë, sidomos krahasuar me kategoritë më të ulëta. Bëhet fjalë për të zgjidhur një problematikë të bartur në mes oficerëve dhe ushtarakëve, që është vështirësia në

punë, e cila është diskriminuese sidomos krahasuar me Policinë e Shtetit. Ne kemi bërë edhe një projekt për t' u njohur vështirësinë disa kategorive të caktuara, të cilat janë shumë të domosdoshme për Forcat Armatosura, por njëkohësisht meritojnë një trajtim më të mirë, bëhet fjalë për pilotët, Forcat Speciale, Forcat e Sigurisë, mjekët dhe infermierët e Forcave Detare. Besoj se kjo do të zgjidhë dallimin që kanë pasur këto kategori me policinë, sikundër projekti i madh për rritjen e pagave në mënyrë të shkallëzuar për të gjitha gradat e ulëta, përfshirë edhe gradën “Major”, dhe do të sjellë një ndryshim të qenësishëm në trajtimin e tyre, por edhe në përmirësimin e kushteve të jetesës për ta.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të jetë e shkallëzuar deri në masën 19% për gradat më të ulëta.

Ermonela Felaj – Sa punonjës pritet që të përfitojnë nga rritja e pagave?

Olta Xhaçka – Do të përfitojnë 6800 punonjës të ushtrisë.

Ermonela Felaj – Që janë kryesisht me grada të ulëta?

Olta Xhaçka – Do të përfitojnë ushtarët, që sapo kanë hyrë në ushtri, përfshirë edhe gradën “Major”. Pra, nuk do të përfitojnë gradat “Nënkolonel”, “Kolonel” dhe “Gjeneral”. Të gjithë të tjerët do të përfitojnë nga rritja e pagës. Ndërkohë, do të përfitojnë nga vështirësia në punë kategoritë: pilotët, forcat speciale, forcat e sigurisë, si dhe mjekët dhe infermierët brenda Forcave të Armatosura.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Zoti Sinaj ka një pyetje dhe më pas zoti Vorpsi.

Vullnet Sinaj – Unë kisha 2 pyetje, por njërin e konsumoi kolegu Sterkaj. Unë jam shumë dakord që ju do të rrisni pagat, duke menduar që ushtarakët janë njerëzit e sakrificave, të cilët na kanë nderuar në të gjitha misionet ushtarake, ku kanë marrë pjesë në bashkëpunim me NATO-n, që ju i përmendët pak më parë, sidomos në drejtimin e reparteve apo misioneve të ndryshme të NATO-s. Kjo tregon për nivelin e lartë dhe përkushtimin e tyre në këtë detyrë të shenjtë që ata kanë për atdheun. Do të thosha që ata e meritojnë vërtet të jenë të vlerësuar dhe të respektuar.

Pyetja e dytë, që unë kam është lidhur me buxhetin për emergjencat civile. Ju thatë dhe ne e dimë që ka disa kohë që Drejtoria e Emergjencave Civile është në drejtim të Ministrisë së Mbrojtjes. Unë po shoh se për vitin 2019, ka një buxhet të vogël, rreth 10 milionë lekë, siç është shkruar këtu.

Mendoj se duhet t'u paraprijmë situatave edhe pse situata e klimës, e natyrës, është e thatë, kjo do të thotë që natyra ka për ta bërë të vetën. Ndoshta do të na ndodhë që të kemi shira në pjesën tjetër të vitit dhe do të duhet të përballojmë situata më të vështira se ato të vitit të kaluar, prandaj mendoj se kjo shifër është e vogël dhe ju duhet ta shihni, ose duhet të bëni ndonjë lëvizje shifrash, ose Ministria e Financave duhet të ndihmojë që të mos ndodhemi në situata të vështira, situata emergjencash dhe në vështirësi ekonomike për t'i përballuar ato.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Sinaj!

Olta Xhaçka – Jam dakord me zotin Sinaj. E thashë edhe pak më parë se me marrjen e emergjencave civile nën përgjegjësi, nuk kemi marrë vetëm përgjegjësinë, por kemi marrë edhe detyrimet dhe jo vetëm detyrimet për t'u bërë ballë sfidave, por edhe detyrimet e prapambetura nga Ministria e Brendshme, për kompensimin e dëmeve të atyre që janë dëmtuar gjatë emergjencave të ndryshme, por edhe problematikat e trashëguara.

Sigurisht, buxheti është, ka qenë dhe do të jetë gjithmonë i pamjaftueshëm. Besoj se do të vazhdojë të jetë i pamjaftueshëm në krahasim me të gjitha sfidat, që ne duhet të adresojmë, por ligji i ri për mbrojtjen civile më jep shpresë se ky do të jetë një problem që do të gjejë zgjidhje, sepse Drejtoria e Emergjencave Civile është vetëm një drejtori koordinuese, pra nuk mund të veprojë. Veprimi është mbështetur dikur nga Ministria e Brendshme dhe sot nga ushtarakët e FAsë të Ministrisë së Mbrojtjes.

E dyta, me ligjin e ri për mbrojtjen civile, duke pasur një ndarje shumë më të mirë dhe shumë më të qartë të buxheteve që duhet t'u dedikohen emergjencave civile nga çdo bashki, të monitoruara nga çdo prefekturë, të mbështetura nga rajoni, nga bashkitë e tjera, sa herë që kanë nevojë, dhe më pas, nga pushteti qendror, do t'u japë një zgjidhje shumë më të mirë adresimeve të resurseve financiare në funksion të përballimit të nevojave që vijnë nga emergjencat civile, nga fatkeqësitë natyrore etj.

Buxheti është i pamjaftueshëm, nëse ne do të merrnim përsipër zgjidhjen e të gjitha problemeve, por të mos harrojmë se aktor kryesor në parandalimin dhe planifikimin së pari, të projekteve parandaluese dhe më pas parandalimit dhe përballimit të emergjencave civile, është pushteti vendor.

Ne i mbështesim vetëm atëherë, kur ata i kanë ezauruar të gjitha kapacitetet e tyre dhe vetëm kur resurset e tyre janë të pamjaftueshme. Kjo është edhe arsyeja pse i kam bërë thirrje herë

pas here pushtetit vendor, kryetarëve të bashkive dhe prefektëve për t'i pasur aleatë në monitorimin e këtyre kapaciteteve dhe në vlerësimin e qartë të situatave të emergjencave civile për të mos abuzuar me thirrjen në ndihmë të FA-së, si zgjidhje e parë. Kjo nuk është zgjidhja e parë, por është zgjidhja e fundit. Prandaj, pushteti vendor duhet të alokojë shumë më mirë fondet. Ligji sot e lë të hapur deri në 3%. Mund të ndodhë që zona apo bashki të riskuara tradicionalisht nuk dedikojnë asnjë lek, pavarësisht se ligji thotë se duhet t'u dedikojnë emergjencave civile deri në 3% të fondeve.

Me ligjin e ri për emergjencat civile do ta bëjmë taksativ detyrimin për të dedikuar buxhet për emergjencat civile dhe për ta përballuar ata të parët dhe pastaj në momentin që ata kanë ezauruar kapacitetet e tyre, do të jemi ne.

Vullnet Sinaj – Faleminderit!

Unë do të doja t'ju vija në ndihmë juve, si ministri për këtë buxhet të emergjencave civile, sepse në fakt më duket i vogël. Unë mendoj se pushteti vendor nuk ka mundësi për të përballuar emergjencat civile. Me situatat që kemi pasur vitin e kaluar në Novoselë dhe në Selenicë, përmytjet e mëdha që ndodhën atje, mendoj se nuk i përballojnë dot. Unë për këto situata flas, sepse kam parë veprimet që ju bëtë me ardhjen e helikopterëve për ardhjen në ndihmë dhe evakuimin e atyre njerëzve që qenë atje. Mendoj se duhet të ketë më shumë shpenzime. Nisur nga kjo klimë kaq e thatë për këtë pjesë të vitit, mendoj se dimri do ta bëjë të vetën dhe prandaj thashë që shifra prej 10-milionësh më duket e vogël. Në vend t'ia lëmë përgjegjësinë pushtetit vendor, të mendojmë që sot për ta rritur këtë buxhet, për të qenë të sigurt që mund t'i përballojmë situatat e emergjencës civile.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Sinaj!

Nëse mundem të ndërhyj, me lejen e zotit Vorpsi për t'i shkuar deri në fund problemit që ngriti zoti Sinaj, meqenëse kemi këtu edhe një përfaqësues nga Ministria e Financave.

Zonja ministre e tha në fakt dhe ky nuk është një diskutim i ri, por ne e kemi përmendur sa herë ka ardhur rasti në këtë komision, se sot pushteti lokal, çdonjëra nga 61 bashkitë, ka detyrimin të ndajë një pjesë të buxhetit të vet vetëm për përballimin e emergjencave civile. Ky detyrim në fakt ka mbetur i shkruar në letër dhe unë nuk e di nëse drafti i ri i ligjit për mbrojtjen civile do të mund të detyrojë bashkitë që ta plotësojnë këtë detyrim. Kam dyshim për faktin që nuk është ligji organik mbi të cilin funksionojnë NJQV-të, prandaj do të doja të pyesja përfaqësuesen

e Ministrisë së Financave: projektligji “Për buxhetin e vitit 2019” a ka parashikuar një pikë të tillë që t’i detyrojë bashkitë, të cilat përveç detyrimeve të tjera, të mos t’i prekin disa transfertë, por t’i përdorin për destinacionin për të cilin u janë dhënë dhe, njëkohësisht të kenë detyrimin që në buxhetet e tyre, të detajojnë shumën që është destinuar vetëm për emergjencat civile? Flas për të gjitha bashkitë pa përjashtim, sepse në gjykimin tim, vetëm bashkëpunimi i Ministrisë së Mbrojtjes me atë të Financave do të mund të na e zgjidhte këtë problem dhe do t’i bënte bashkitë që të mos e kishin në diskrecionin e tyre këtë çështje (duan e vendosin, nuk duan nuk e vendosin), por ta kenë si detyrim ligjor dhe në rast se nuk i përgjigjen këtij detyrimi ligjor, të mbanin të gjitha përgjegjësitë që do të vinin më pas.

Ina Dhaskal – Faleminderit për pyetjen!

Për sa i përket detyrimit të NJQV-ve, siç e dini, ekziston edhe një ligj për autonominë e njësive të qeverisjes vendore në planifikimin e buxhetit të tyre. Dihet që buxheti qendror i mbështet në formën e një transferte të pakushtëzuar dhe të një transferte specifike, që shkon për qëllime të caktuara, një ndër të cilat ka qenë edhe ajo e emergjencave civile.

Për sa i përket detyrimit që ne t’i detyrojmë ligjërisht ato, kuptohet që duhet parë mirë ndërhyrja në bazën ligjore përkatëse. Meqenëse unë nuk jam ekspertja e fushës për njësitë e qeverisjes vendore, mendoj ta mbaj shënim këtë çështje dhe t’i kthejmë komisionit një përgjigje zyrtare me shkrim për propozimet e bëra.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit, zonja Dhaskali!

Fjala është për zotin Vorpsi dhe më pas për zotin Harusha!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, besoj se do të na ndihmonte edhe neve për ta vënë në raportin, që do t’i çojmë Komisionit të Ekonomisë. Mund ta bëni sqarimin!

Alba Thoma- Faleminderit!

Deshëm të sqarojmë se jemi në fazën e një drafti, që nuk ka kaluar për konsultim, por jemi të bindur se ajo që do të propozojmë, do të jetë zgjidhja më e mirë e mundshme.

Propozimi qëndron në këtë pikë: referuar legjislacionit në fuqi për qeverisjen vendore, prefekti është institucioni që miraton buxhetin e çdo bashkie. Në këto kushte, kemi bërë një dispozitë ligjore, e cila në momentin që bashkia do të çojë për miratim te prefekti buxhetin e saj

vjetor, ai nuk mund ta certifikojë këtë buxhet, nëse nuk do të ketë të parashikuar atë detyrim ligjor të caktuar nga ligji për pjesën e buxhetit të dedikuar për emergjencat civile për çdo bashki.

Sigurisht, parashikojmë edhe një dispozitë tjetër, që do t'i japë mundësi Ministrisë së Financave që kur bën pjesën e fondit të pakushtëzuar, të ketë mundësi ta kontrollojë bashkinë dhe t'i kërkojë asaj të parashikojë edhe pjesën e emergjencave civile.

Duhet të kuptojmë se ndërhyrja në një strukturë të vetme, siç është bashkia, kur emergjenca është në atë bashki, ka kosto shumë më të vogla sesa kur ndërhyrja qeverisja qendrore për të gjitha llojet e emergjencave.

Duhet të kuptojmë të paktën nga eksperiencia që kemi në këtë vit në Ministrinë e Mbrojtjes, që emergjencat kanë qenë pjesë integrale e saj, kërkesat vijnë që nga gurët që bien në rrugë, deri te emergjencat nga përmytjet, nga zjarret etj., që rrezikojnë realisht jetën e njerëzve. Institucionet qendrore qoftë Ministria e Mbrojtjes apo të gjitha ministratë nuk mund t'i përballojnë të vetme këto gjëra. Bashkitë janë ato njësi më të vogla, të cilat referuar legjislacionit të tyre të brendshëm, ligjit për qeverisjen vendore, duhet të parashikojnë detyrimin e tyre dhe t'i dalin ato përpara emergjencës që i takon brenda territorit të saj.

Patjetër, nëse do të kemi një emergjencë që tejkalon një bashki, do të veprohet në nivel rajonesh dhe do të bashkëpunohet me njëra-tjetrën për të kaluar më pas në një ndihmë më të madhe, që do të ishte ajo e ministrisë apo e qeverisjes qendrore. Nuk e di nëse isha e qartë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Nuk diskutohet që bashkitë duhet ta kenë këtë detyrim. Edhe më parë qeverisja qendrore ka ndërhyrë për ta rregulluar në mënyrë definitive përgjegjësinë e njësive të qeverisjes vendore. Kujtoj këtu ligjin për financat e qeverisjes vendore dhe për këtë më ndihmon edhe përfaqësuesja e Ministrisë së Financave, i cili i detyron bashkitë që në shpenzimet e tyre të mos shkojnë përtej një kufiri të caktuar, duke futur bashkinë në borxh. Sanksioni që vjen më pas është bllokimi në thesar i tyre dhe këtë vendim e merr ministri i Financave. Nuk e di por mendoja të jetë një gjë e ngjashme, gjithmonë duke pasur parasysh që ligji i veçantë e paraprin ligjin e përgjithshëm, kur flasim për institucionin, që duhet ta zbatojë këtë. Ta bëni këtë zgjidhje dhe të mos ta vononi në mënyrë që përballimi i emergjencave të bëhet, ashtu siç e kërkon logjika dhe zonja ministre e përmendi disa herë që bashkërisht, njësitë e qeverisjes vendore dhe ajo qendrore duhet të përballojnë emergjencat civile.

Fjala për ju, zoti Vorbsi!

Sadi Vorpsi – Faleminderit, zonja kryetare!

Natyrisht, e përgëzoj Ministrinë e Mbrojtjes dhe qeverinë në rastin konkret që në këtë buxhet, që për mendimin tim është shumë ambicioz, realizon pothuajse të gjitha objektivat e qeverisë për sa i përket sigurisë kombëtare, por edhe detyrimeve, që kemi karshi partnerëve tanë.

Bashkohem me të gjitha pyetjet, që morën edhe përgjigje nga ju. Në fakt, disa nga pyetjet që unë kisha për të bërë, janë ezauruar. Si deputet i parlamentit, si i zgjedhur, patjetër kemi kaluar në këto 2 vjet fatkeqësi natyrore dhe nga viti në vit ka një ndryshim shumë pozitiv, sidomos në këtë vit, për menaxhimin apo për planifikimin e tyre. Ju u shprehët shumë qartë që keni trashëguar nga Ministria e Brendshme borxhe për fondet e kompensimit të dëmeve materiale të qytetarëve.

Pyetja ime është: sa është borxhi që ju keni trashëguar? A është planifikuar ky dëmshpërblim dhe ky kompensim ndaj qytetarëve?

Jua thashë edhe më parë, ne jemi deputetë, shkojmë nëpër zona dhe njerëzit e presin këtë kompensim prej 1 viti, 2 vjetësh, disa edhe prej 3 vjetësh, ndërkohë që... Sigurisht, ky është një borxh që duhet kompensuar sa më shpejt.

Për pjesën tjetër, për buxhetin që ka sot Drejtoria e Emergjencave Civile, natyrisht, bashkohem me Vullnetin dhe me kolegët e tjerë. Natyrisht, Drejtoria e Emergjencave Civile është një institucion kordinues dhe unë mendoj se bashkitë duhet të jenë ato që duhet ta planifikojnë 3-përqindëshin, pavarësisht se u është lënë një hapësirë 0-3%.

Për situatën aktuale, e thatë edhe ju, por e diskutuam edhe këtu, po planifikohet një ligj i ri për emergjencat civile. Institucioni i emergjencave që është sot, mendoj se duhet të fuqizohet, duke filluar që nga numri apo nga struktura. Ne kemi bërë një vizitë aty. Një strukturë prej 13 vetash në Drejtorinë e Emergjencave Civile, për mendimin tim, është pak, natyrisht, edhe pjesa e logjistikës që kanë.

Këto ishin sugjerimet. Bëra edhe një pyetje dhe doja të dija për...

Ermonela Felaj – Besoj se pyetja është e qartë për ministrinë.

Mund të kemi një përgjigje?

Olta Xhaçka – Ju falënderoj!

Është shumë e drejtë ajo që thoni. Drejtoria e Emergjencave Civile në këtë moment është vetëm një njësi kordinuese dhe nuk merr përsipër asnjë lloj përpjekjeje logjistike, pa diskutim. Krahu i forcës, le të themi, është Forca e Armatosur, dikur ishte Policia e Shtetit, por edhe të gjithë aktorët e tjerë që përfshihen në rastin e një emergjence civile.

Të jeni të sigurt që Drejtoria e Emergjencave Civile do të vazhdojë të mbetet sërish një njësi koordinuese, pavarësisht se me ligjin e ri do të jetë shumë më e fuqizuar, nga një drejtori do të jetë një agjenci, e cila do të fuqizohet edhe në ato profesione apo profile pune, të cilat janë shumë të domosdoshme për vlerësimin e situatave të emergjencave civile, që sot në drejtorinë ekzistuese mungojnë. Me ligjin e ri këto do të parashikohen në një organikë tjetër, në një agjenci që bën një kordinim shumë më të mirë të vlerësimit të situatave, të kordinimit të të gjithë aktorëve, kur ka nevojë për ta adresuar situatën, edhe të projekteve parandaluese, të cilat mund të asistojnë pushtetin vendor, por edhe pushtetin qendror, në parashikimin e të gjitha projekteve që mund të ndërmarrim për të minimizuar riskun e emergjencave, jo thjesht për përballimin e tyre.

Për sa i takon borxhit të trashëguar, ai sot është rreth 700 milionë. Në qershor kemi disbursuar rreth 48 milionë, që kanë shkuar për 100 familjet e dëmtuara...

Nga tërmetet?

Alba Thoma – Nga fatkeqësi të ndryshme.

Olta Xhaçka – Nga fatkeqësi të ndryshme natyrore.

Këtë vit planifikojmë të disbursojmë 130 milionë të tjera, sërish në adresë të familjeve të dëmtuara, që i ulin këtij borxhi një shumë relativisht të qenësishme.

Do të vazhdojmë me këto ritme, me shpresën për ta ulur në një kohë sa më të shkurtër 700-milionëshin e trashëguar nga Ministria e Brendshme.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Zoti Harusha...

Luan Harusha – Faleminderit, kryetare!

Kisha një pyetje, zonja Ministre.

Në disa pika fatkeqësitë natyrore godasin vit mbas viti dhe shpenzimet janë vit mbas viti. Po flas për qarkun e Shkodrës, por si qarku i Shkodrës ka në të gjithë Shqipërinë dhe e njëjta situatë ndodh çdo vit.

A është e mundur t'u paraprijmë këtyre problemeve me disa projekte afatgjata?

Faleminderit!

Olta Xhaçka – Patjetër, është e mundur, por siç jua thashë, edhe në ligjin ekzistues për emergjencat civile, edhe në ligjin e ri për mbrojtjen civile, përgjegjësia kryesore i takon pushtetit vendor, për planifikimin, parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile. Ne nuk marrim dot përsipër projektet parandaluese që mund t'i bënte bashkia në territorin saj. Pa diskutim, mbi bazën

e një projekti pushteti vendor të kërkojë edhe mundësinë e burimeve financiare, që nuk ekzistojnë në buxhetin e tij, të kërkojë edhe ndihmën e aktorëve të tjerë shtetërorë, qoftë edhe të Ministrisë së Mbrojtjes, siç po bëjmë sot në Fier me një projekt parandalues të përmytjeve që ndodhin në lumin Vjosë, qoftë edhe të aktorëve të tjerë që mund të ndihmojnë, edhe përmes buxheteve të veçanta, siç është rasti i Gjirokastrës dhe Kodrës së Shtufit, ku nga Këshilli i Ministrave u akordua një fond prej 85 milionë, i cili shkon për ndërhyrje në pallatin që ka pësuar dëmtime. E gjithë kjo duhet të iniciojë nga pushteti vendor, nga bashkitë dhe nuk mund të iniciojë prej nesh. Ne jemi gjithmonë të gatshëm për të ndihmuar dhe mbështetur për përballimin e pasojave pasi ndodhin emergjencat, ose të mbështesim me krahë pune, me Forcat e Armatosura, projekte që janë parandaluese, por që e kanë filluesën gjithmonë nga pushteti vendor.

Luan Harusha – Flas për disa pika ku çdo vit është e njëjta situatë, nuk po flas për fatkeqësitë. Po marr shembull zonën e Shkodrës dhe zonën e Nënshkodrës, ku çdo vit ka përmytje dhe ministria, qeveria (nuk ka rëndësi qeveria e sotme apo ajo e kaluar), hedh lekë kot çdo vit dhe kjo është e pazgjidhshme. Hidhen lekë për momentin, nuk e di, por...

Zona te lumi Kir për çdo vit merr 10-15 mijë metra tokë. Janë disa gjëra që vijnë çdo vit në të njëjtën kohë. Rruga e Dukagjinit bllokohet. Po flas për një projekt afatgjatë....

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Zoti Duzha...

Paulin Sterkaj – Në mbështetje të Luanit kisha për të thënë diçka. Meqenëse flitet për Shkodrën, ku emergjencat më të mëdha vijnë nga problemet me përmytjen, përmytja nuk vjen nga reshjet, por vjen nga hidrocentralet që ka kaskada e Drinit...

Tani, a nuk do të ishte mirë që edhe OSSHE-ja të parashikonte një fond për dëmet që i bën popullit të Shkodrës, në momentin kur përmyten, që të përballohet kjo situatë? Ne nuk guxojmë të Shkojmë në Shkodër, se thonë nuk na keni dëmshpërblyer, nuk na keni dhënë fondet që jemi dëmtuar. Të gjithë e dinë që bëhet shkarkimi i hidrocentraleve, shikohen dhe...

Desha të thosha edhe diçka tjetër. Unë nuk mendoj që pushteti lokal i ka të gjitha mundësitë për të përballuar emergjencat, përveçse të parashikojë, se nuk ka asnjë fond në zonën e emergjencave të pushtetit lokal. Fondet, nga qeveria i shkojnë Ministrisë së Mbrojtjes dhe, natyrshëm, i ka sektori i Emergjencave Civile.

Qeveria ka përqindjen e rasteve të jashtëzakonshme, që mund ta lëvrojë, por asnjë njeri nuk mund të parashikojë se si mund të vijnë fatkeqësitë natyrore. Edhe pushteti lokal është

kroinator, sepse nuk e ka mundësinë fizike dhe financiare për të përballuar emergjencat civile, që janë të paparashikueshme.

Kështu që do të ishte më mirë të rritej fondi te Ministria e Mbrojtjes sesa te pushteti lokal, sepse kontrollohet dhe administrohet shumë më mirë. A do të ishte mirë të parashikohej për Shkodrën dhe për disa qarqe të tjera, të cilët kanë vite që përmyten?

Olta Xhaçka – Faleminderit, zoti Sterkaj!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E mirëkuptoj shqetësimin. Ky ka qenë një shqetësim edhe yni për të paktën 3 muaj gjatë ndërhyrjeve tona të vazhdueshme në zonën e Nënshkodrës për përmytjet e muajit mars. I mirëkuptoj të gjithë, ju si përfaqësues të atyre banorëve, por edhe vetë banorët për vështirësitë e jashtëzakonshme me të cilat përballen vit pas viti.

Dua të theksoj se Ministria e Mbrojtjes është koordinatore në të gjithë këtë proces. Koordinon përpjekjet e të gjithë aktorëve të tjerë, që kanë përgjegjësi parandalimin dhe adresimin e emergjencave civile. Nuk është aktori i vetëm. Sa herë ushtria lëviz, lëviz me “pasoja”, sepse ka kostot e saj të lëvizjes. Ndonjëherë është shumë efiçiente që kapacitetet vendore, nëse ekzistojnë, të veprojnë të parat dhe pastaj, kur ezaurohen, Forcat e Armatosur me numrat e saj, por edhe të gjithë aktorët e tjerë që kanë përgjegjësi në adresimin e fatkeqësisë apo pasojave të fatkeqësisë, të veprojnë në mënyrë të koordinuar. Në këtë kuptim, ne bëjmë koordinatorin.

Buxheti që ne kemi të alokuar është i papërfillshëm krahasuar me sa mund të alokojnë bashkitë e mëdha që kanë buxhete shumë të mëdha. 3%-i i Bashkisë së Tiranës është pesëfish apo gjashtëfish i buxhetit vjetor që kemi ne për koordinimin e emergjencave civile.

Bashkitë veprojnë mbi bazën e planifikimit dhe projekteve të parandalimit, jo thjesht me fondet buxhetore që ato kanë në dispozicion për atë vit, por edhe me mbështetje përmes fondeve të veçanta, nëse kanë projekte të sakta, racionale dhe të mirëstudiuara për ndërhyrjet që duhen bërë për parandalimin e pasojave të fatkeqësive natyrore apo emergjencave të çfarëdolloj.

Në këtë pikë, na duhet një buxhet më i madh, sepse kemi një borxh të trashëguar, si dhe kemi për të shlyer ende dëmtime që ju janë shkaktuar ndër vite shumë familjeve për shkak të emergjencave. Ne lëvizim sa herë duhet të mbështesim me kapacitetet tona pushtetin vendor atje ku ai ezauron të vetat, por kjo nuk do të thotë që këtë përgjegjësi duhet ta mbajmë të gjithën ne. Secili ka përgjegjësinë e vet, të cilën duhet ta ushtojë mirë. Atje ku ezaurojnë mundësitë, duhet të kërkojë ndihmë, por mbi bazën e projekteve të mirëstudiuara.

Nuk dua të paragjykoj, sepse nuk është puna jonë, por unë nuk kam parë një projekt të mirëstudiuar, që kërkon fonde për të evituar problematikën që ndodh vit pas viti në Shkodër.

Kam parë një projekt të bashkisë së Fierit për rehabilitimin e argjinaturës 3,5 kilometra të gjatë të lumit Vjosë, që ne po e mbështesim me Forcat e Armatosura. Duke qenë se është një projekt parandalues, kostot e projektit janë shumë herë më të ulëta se çdo të ishte ndërhyrja jonë kur përmbytja të ndodhte apo shumë më ulëta nga sa ka kushtuar ndërhyrja jonë në nëntor-dhjetor kur u përmbyt zona e Fierit dhe e Vlorës. Është shumë më efiçiente, racionale, por edhe ekonomike që të marrim masa përpara se gjërat të ndodhin. Nëse ka projekte të mirëstudiuara, jemi të gjithë të gatshëm t'i mbështesim. Nuk është vetëm buxheti i shtetit që mbështet financiarisht, ka edhe mekanizma të tjerë, por e gjitha e ka fillesën te projekti.

Ermonela Felaj – Në fakt, çështjen e emergjencave civile ne e kemi parë gjithmonë të lidhur si problem të tri ministrive. Së bashku më ministrinë që ju drejtoni, Ministria e Bujqësisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë kanë përgjegjësitë e veta në këtë gjë. Vetëm nëse këto tri ministri dhe pushteti lokal do të bëhen bashkë mund të themi që i kemi përballuar me sukses në çdo drejtim emergjencat civile. E kemi parë në terren që emergjencat civile ndërhyjnë në përballimin e pasojave, ndërkohë ka shumë rëndësi analizimi i të gjitha shkaqeve që çojnë në përmbytje, me qëllim që t'i parandalojmë.

Nëse kolegët më lejojnë, dua të kthehem te misioni qendror që kanë Forcat e Armatosura dhe përgjegjësitë kryesore që ka Ministria e Mbrojtjes lidhur me to.

Sa parashikohet të jenë financimet e huaja për Ministrinë e Mbrojtjes për vitin që vjen dhe ku mendohet të adresohen?

Bardhyl Kollçaku – Faleminderit për pyetjen!

Ashtu siç zonja ministre e përmendi, Forcat e Armatosura janë të fokusuara në realizimin e misionit dhe detyrave që rrjedhin nga strategjia ushtarake kombëtare, nga plani afatgjatë i zhvillimit dhe programet e mbrojtjes. Prioritetet tona shkojnë edhe në angazhimet dhe detyrimet që kemi në kuadrin e Aleancës. Kuptohet, trajnimi, stërvitja dhe edukimi janë prioritetet kyçe të Forcave të Armatosura, krahas modernizimit dhe krijimit të kushteve për punë në stërvitje.

Përveç buxhetit të alokuar nga qeveria, Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura përfitojnë edhe disa grante apo asistencë në kuadrin e bashkëpunimit të programeve të asistencës me partnerët tanë. Këtu dua të përmend partnerin tonë strategjik Shtetet e Bashkuara të Amerikës me rreth 1 milion dollarë nëpërmjet programi IMET (*International Military Education &*

Training), grantin turk po 1 milion dollarë, që shkon jo vetëm për trajnim, edukim dhe stërvitje, por edhe për asistencë, si dhe programe të tjera bashkëpunimi me Mbretërinë e Bashkuar, Gjermaninë, Italinë dhe partnerë të tjerë të NATO-s dhe jo të NATO-s.

Kuptohet, përfitimi i Forcave të Armatosura nga ky bashkëpunim është i dukshëm, sepse i shërben rritjes së profesionalizmit. Politikat e miratuara nga Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i shërbejnë rritjes së transparencës dhe meritokracisë për të përzgjedhur, dërguar dhe për të krijuar kushte për ta mbajtur këtë investim që përfitohet nga bashkëpunimi me aleatët tanë strategjik.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Përafërsisht, sa shkon ndihma e huaj për vitin 2019?

Dy milion dollarë vinin nga ndihmat amerikane dhe nga granti turk, por ju përmendët edhe të tjera. Sa vlerësohet të jetë?

Bardhyl Kollçaku – Programet nuk janë fikse, sepse miratohen çdo vit. Ne jemi në kuadrin e miratimit të planeve të bashkëpunimit me këto që përmenda, por edhe të tjerë. Në momentin që flasim nuk mund të japim një shifër konkrete, por është e rëndësishme që ne kemi rritur bashkëpunimin dhe synojmë ta rrisim edhe më tej edhe në vitet që vijnë.

Olta Xhaçka – Vlen të thuhet që kemi edhe disa projekte në vazhdim. Bëhet fjalë për një ndihmë të qenësishme, disa dhjetëra milionë dollarë, por pritet që aleati ynë strategjik t'i miratojë në të gjitha institucionet e veta në kongres. Kjo nuk është asgjë që mund ta ndajmë me ju sot, por shumë shpejt do të bëhet realitet.

Ermonela Felaj – Për sa u përket planeve që NATO ka, aleati ynë strategjik, sikundër ju e përmendët, një nga gjërat më të rëndësishme për Shqipërinë është baza ajrore e Kuçovës. Ju thatë që keni edhe plane të përbashkëta. Jo vetëm për interesin tim si e zgjedhur në atë zonë elektorale, por edhe për interesin e publikut, do të doja të kishim një informacion më të plotë rreth kësaj. Çfarë pritet të investohet? Kur do të fillojë investimi? Sa do të zgjasë? Cili do të jetë roli që do të ketë pala shqiptare në këtë investim kaq të rëndësishëm për vendin?

Olta Xhaçka – Pa diskutim, ky është prioriteti ynë kryesor. Kemi ngritur grupet e punës, të cilët mund të facilitojnë përshpejtimin e hapave që duhet të marrë ndërtimi i bazës së Kuçovës. Do të fillojmë që këtë vit me disbursimin e një pjesë të fondit, bëhet fjalë për mbi 50 milionë euro investim, i cili është vetëm fillestar. Do të jetë më tepër se sa kaq. Bëhet fjalë për një investim të shtrirë në disa vite dhe në disa faza, është një informacion që nuk mund ta ndaj në detaje, por

mund të them se do të fillojmë që këtë vit me masterplanin dhe me projektin për bazën, për të vijuar menjëherë në vitin 2019 me tullën e parë, me fillimin e investimit, të cilit do t'i japim një ritëm shumë të shpejtë, duke e ndjekur me shumë prioritet.

Nëse mundet ta konsiderojmë fond të huaj, edhe ky pa diskutim që është fond i huaj, nuk vjen nga buxheti ynë, por bëhet fjalë për fondet e përbashkëta të NATO-s që investohen në bazën ajrore të Kuçovës. Do të jetë një projekt i një rëndësie të veçantë, jo vetëm për zonën atje, jo vetëm për Kuçovën, jo vetëm për Shqipërinë, por për të gjithë rajonin. Është baza e parë ajrore e NATO-s në Ballkanin Perëndimor dhe pa diskutim na vë në pozicionin e një përgjegjësie të veçantë për mbrojtjen, sigurinë dhe për rolin e Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor.

Ermonela Felaj – Po, zoti Duzha.

Luan Duzha - Faleminderit zonja kryetare!

Faleminderit, zonja ministre për të gjitha prioritetet që parashtruat për projektbuxhetin e vitit 2019 për Ministrinë e Mbrojtjes.

Unë dua të di: çfarë do të bëhet me 3 uzinat ushtarake, konkretisht e kam fjalën për uzinën e lëndëve plasëse në Mjekës, ku jam deputet, pasi në dijeninë time, punonjësit që janë aty kanë disa muaj që nuk marrin as pagat. A është parashikuar ndonjë gjë në projektbuxhetin e vitit 2019, meqenëse jemi ende në miratimin në tërësi të tij?

Nuri Laknori - Ju faleminderit për pyetjen!

Unë jam drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar. Lidhur me pyetjen tuaj, mund të them se e pranojmë që situata e ndërmarrjeve është pak delikate. Ndërmarrjet kanë punuar, kryesisht për procesin e demontimit të municioneve të tepërta të Ministrisë së Mbrojtjes, një proces, i cili tashmë ka përfunduar. Kemi marrë të gjitha masat për të bërë të mundur që ndërmarrjet të mos krijojnë detyrime të reja. Për këtë kemi ngritur dhe grupe pune dhe jemi tashmë në një përfundim, ku do të sugjerojmë pranë titullarit të ministrisë vijimësinë e këtyre ndërmarrjeve në procesin e parashikuar për to.

Situata realisht është problematike, por në buxhet ne nuk mund të parashikojmë fonde për ndërmarrjet ushtarake, sepse ndërmarrjet funksionojnë bazuar në ligjin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj- Zoti Luzha, ju lutem me mikrofon, nëse keni ndërhyrje!

Luan Luzha - E kisha konkretisht me Mjekësin. Punëtorët vazhdojnë të shkojnë në punë, paga nuk marrin. Të paktën të mos shkojnë në punë. Mendoj që ministria duhet të ndërhyjë që

punonjësit të mos shkojnë në punë, sepse do të rritet borxhi dhe do të bëhen 6-8 muaj pa marrë pagat.

Olta Xhaçka - Ndërmarrjet janë sh.a dhe ne nuk dedikojmë dot buxhet për menaxhimin e tyre apo për borxhet që mund të krijojnë. Drejtorët e ndërmarrjeve pa diskutim duhet të ushtrojnë diskrecionin e tyre për mirëmenaxhimin e situatës për të mos krijuar borxh më tepër nga ai që është krijuar sot.

E tha pak edhe zoti Laknori, procesi i demontimit, pothuajse ka përfunduar. Unë e di se Mjekësi po demonton sot edhe një pjesë, janë sasi shumë të vogla të mbetjeve që ne kemi gjetur nga pastrimi i *hotspote*-ve kryesisht në tunelet e Selicës, por me të mbaruar atë proces, do të duhet që titullarët e uzinës të marrin një vendim, se çfarë do të bëjnë me mbarëvajtjen apo me vazhdueshmërinë e institucionit, sepse nuk mund të mbajmë një uzinë që nuk është rentabël.

Nga ana tjetër, unë kam bërë të pamundurën që në cilësinë e ministrit edhe në diskutime me partnerët për të afruar investitorë seriozë të industrive të tyre ushtarake, të cilët mund të vijnë në uzinat tona, mund të rivitalizojnë pjesë të tyre, duke pasur parasysh njerëz shumë të profilizuar apo me eksperiencë në atë sektor, të cilët mund të ishin specialistë shumë të mirë të këtyre investimeve, nëse do të kishin interes. Jemi në diskutime me disa prej tyre, ka pasur një investitor, në rastin e Mjekësit. Besoj se do të realizohet shumë shpejt. Projekti është në Ministrinë e Financave. Bëhet fjalë për investitor shumë serioz, që ka interes dhe krahu i punës apo njerëzit, të cilët janë specialistë të profilizuar të asaj industrie, do ta gjejnë veten në këto iniciative të reja.

Për sa i takon mirëmenaxhimit, i takon titullarit të uzinës që ta ushtrojë këtë përgjegjësi. Sërisht është përgjegjësi e tij, jo e ministrisë dhe jo përmes buxhetit tonë, sepse nuk na lejohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj - Ju lutem!

Kishte një ndërhyrje zoti Qefalia. Pastaj fjalën e ka zoti Sinaj.

Xhemal Qefalia – Faleminderit!

Unë nuk do të ndalem te pjesa e diskutimeve, sepse e kalova te pjesa e relatimit, vetëm dua të them se fokusi kryesor edhe i pyetjeve të kolegëve, ishin të drejta, për sa u përket emergjencave civile, ndërkohë që detyra parësore e ministrisë nuk është emergjenca, por unë si ushtarak, edhe gjenerali, zoti Sinaj, zoti Luzha e dimë shumë mirë pse pyetjet adresohen që t'i kalojnë Ministrisë së Mbrotjtjes, sepse vetëm ushtarakët i marrin gjërat seriozisht dhe i realizojnë detyrat deri në fund, prandaj insistohet në këtë fokus.

Zonja kryetare, do të doja që si Komision për Sigurinë mbështetur edhe në pyetjen që bëri, me të drejtë kolegu Vorpsi duhet t'i kërkojmë Ministrisë së Financave, që fondi i borxheve të mbartura nga Ministria e Brendshme tek ajo e Mbrojtjes të jetë një fond më i madh që të bëhet likuidimi i të gjithë detyrimeve që ka, që të mos cenohet aspak fondi që i shërben drejtpërdrejt misionit që ka vetë ministria.

Ermonela Felaj - Po, zoti Sinaj.

Vullnet Sinaj – Do t'ju kërkoja ndjesë, por dua të mbështes kolegun. Ku i marrin sh.a-të, firmat private, ku kanë tenderuar, te cila ministri? Te Ministria e Financave, te Ministria e Mbrojtjes? Kush i paguan për punën, kush e ka kontraktuar punën?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Olta Xhaçka- Kontraktojnë punë nga ne ose nga aktorë të tjerë nëse janë të licensuar. I paguajmë kur kontraktojnë punë nga ne. Nuk i paguajmë nëse nuk kanë punë. Nuk na lejohet me ligj.

Vullnet Sinaj - I keni paguar ju? Është gjynah të qëndrojnë punëtorët pa u paguar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë ka qenë zgjedhje e gabuar.

Mbyllet mbledhja.

MBYLLET MBLEDHJA